



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.01/12/2021

Dt.16.12.2021

Njësia e burimeve njerëzore (NJB NJ)

Njësia e burimeve njerëzore (NJB NJ) në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 41 paragrafit 5 pika 5.2 të Ligjit për Zyrtar Publik dhe nenit 10 paragrafi 7 të Rregullores nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disciplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, bënë këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

për dy (2) ekspert të jashtëm në fushën e përzgjedhjes / vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuara apo universitete

Detyrat dhe përgjegjësitë

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i Komisionit të Pranimin në kuadër të Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe do të kryej detyrat e tij, ashtu siç janë të përcaktuara në Rregulloren nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disciplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kriteret e kërkuara:

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës. Së paku njëri nga anëtarët duhet të posedoj specializim në gjuhë zyrtare dhe komunikim;
2. të kenë përvojë pune të paktën katër (4) vite në pozita të nivelit drejtues;
3. të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
4. të kenë integritet moral dhe profesional;
5. të mos kenë qenë të dënuar penalisht për kryerjen e një veprë penale;
6. të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Pagesa: Eksperti i jashtëm paguhet me një pagesë fikse në shumën prej 250 euro e cila i paguhet ekspertit për çdo procedurë të konkurrimit në të cilën është i angazhuar në përputhje me nenin 11 të Rregullores nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disciplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kohëzgjatja e emërimit: 2 (dy) vite

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentacionet si më poshtë:

- CV-në
- Fotokopje të diplomës të vërtetuar;
- Fotokopje të letërnjoftimi (ID);
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshminë që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprë penale;
- Deklaratën se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Deklaratën se nuk është i punësuar në shërbimin civil, se nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Organizatave të specializuara mund të aplikojnë përmes postës elektronike dhe dokumentet e kërkuara t'i dorëzojnë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, rr. "Zenel Salihu" nr. 22, Prishtinë ose t'i dërgojnë në email adresën: adelina.sopi@rks-gov.net

Organizatave të specializuara duhet t'i ofrojnë për kandidatët e tyre të dhënat e sakta mbi adresën dhe numrin e telefonit kontaktues.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë organizatat e specializuara që të aplikojnë me kandidatët që i plotësojnë kriteret e shpalljes.

Shpallja mbetet e hapur nga data 16/12/2021 deri më 21/12/2021 në ora 16:00.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në nr. tel: 038-200 62 952 ose e-mail adresën: adelina.sopi@rks-gov.net.